



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.478/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Ferit Osmani dhe Vllastimir Dimiq anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë si e pasafatshme ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 në ora 11:15 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK në të cilën theksohet anëtarët e LDK-se se me datën 10.12.2010 rreth orës 11:00 në rrugën Dëshmorët e Kombit në lagjen Shipol të Mitrovicës në vendin ku ka qenë i vendosur poster i kryetarit të PDK-ës Hashim Thaçit, kanë vendosur posterin e kandidatëve për deputet të LDK-ës dega në Mitrovicë, Sadri Ferati dhe Vjosa Osmani dhe me këtë veprim të tyre kanë vepruar në kundërshtim me nenin 33 pika a) të LZP-ës.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi nga vendi i ngjarjes.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 4, parasheh si vijon:

Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet brenda shtatëdhjetë (72) orë.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e pasafatshme për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkak se në rastin konkret supozohet se shkelja ka ndodhur me 10.12.2010 në ora 11:00, ndërsa në PZAP ankesa ka arritur me 13.12.2010 në orën 11:15 çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë për tu dorëzuar me kohë. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 478/2010 më datën 14.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

